

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 51, deri më 22.12.2024)

Të dhëna javore


Gjatë javës së pesëdhjetë e një të vitit 2024 (nga 16-22.12.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **139 (I=7,6/100.000)** të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 17,8% më shumë se javën e kaluar (118).

Krahasuar me javën e pesëdhjetë e një të vitit të kaluar (205), numri është zvogëluar për 32,2%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (152) është regjistruar një rënie prej 8,7%.

Gjatë javës së 51 të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 21 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara edhe për grip edhe për COVID-19, një material ka rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit Influenza A(H3), dhe një rast pozitiv me RSV.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=26,1/100.000) është nën pragun sezonal, pra ende nuk është arritur pragu i aktivitetit sezonal për hyrje në sezonin e gripit (Grafiku 1).

Grafiku 1. Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025




Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në Dibër –42, Gostivar – 33, Kumanovë-22, Tetovë – 15, ndërsa në Prilep, Shkup, Kavadar, Ohër, Strugë, Negotinë, Strumicë, Makedonski Brod, Manastir, Sveti Nikole, Kratovë dhe Shtip numri i të sëmurëve është më i vogël se 5.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 95 persona, tek grupmosha 5-14 – 24, tek grupmosha mbi 65 vjet – 8 dhe tek fëmijët nga 0-4 -12 raste. Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (12,4/100.000).

Në 14 njësi raportimi është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në një sezonal dhe në një aktivitet mesatar (hartogrami 1).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e 51, 2024



МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE – Të dhëna kumulative

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është **799 (I=43,5/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=890), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rënie prej 10,2%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=841) është regjistruar një rënie prej 4,9%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 21 QSHP/NJR. Numri më i madh (n=203) është regjistruar në Gostivar, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (423,4/100.000) është regjistruar në territorin e Dibrës.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) - 500 raste (62,6%), ndërsa incidencë më e lartë (68,4/100.000) tek fëmijët e moshës 0-4 vjet (n=147).

Shpërndarja e rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas muajve

- tetor – 195 raste ose 24,4%
- nëntor – 259 raste ose 32,4%
- dhjetor – 345 raste ose 43,2%

Deri më tani nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

МБИКËQYRJA VIROLOGJIKE

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e 51, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 191 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Deri më tani janë regjistruar 2 raste me SARS-CoV-2 dhe 4 me RSV, dhe një rast me grip - Influenza A(H1)pdm09, një me Influenza A(H3).

КОМЕНТ EPIDEMIOLOGJIК

Ka një rritje të numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është ende nën kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e mbikëqyrjes virologjike të gripit tregojnë se ka pasur aktivitet sporadik të virusit të influencës gjatë dymbëdhjetë javëve të fundit të mbikëqyrjes. Sipas këtyre të dhënave, Maqedonia e Veriut ka intensitet të ulët të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.235 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.890 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 72.125 persona me vakcina falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN - ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary)

*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e 50 të sezonit të ri 2024/2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 20 nga 33 vende të rajonit evropian të OBSH-së.
- Java e 48 e shënoi fillimin e sezonit epidemik të gripit 2024/2025. Intensiteti i gripit këtë javë ishte mesatar në 10 vende. Po rritet edhe përqindja e rasteve pozitive me grip dhe hospitalizimeve. Numri më i madh i rasteve pozitive me grip i përkasin A(H1)pdm09.
- Numri i rasteve pozitive me RSV në rajon vazhdon të rritet. Në nivel rajonal po rritet numri i pranimev në pital dhe në repartet e kujdesit intensiv për RSV.

- Në nivel rajonal, numri i rasteve me SARS-CoV-2 ka filluar të shënojë një rënie të ngadaltë, por me dallime mes vendeve. Pranimet si pasojë e SARS-COV-2 po vazhdojnë të bien. Grupmoshat më të moshuara vazhdojnë të përfaqësojnë numrin më të madh të rasteve.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik**